



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.2.2021, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 2 dhe 4 shkurt 2021.
2. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”.
3. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm dhe ankesat në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale”.
4. Miratimi i planit vjetor 2021 për zbatimin e programit të statistikave zyrtare 2017 – 2021.
5. Mbi vendimin e Kuvendit për përcaktimin e fondit për subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet 2021.

Marrin pjesë:

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Xhevit Bushaj, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Ervin Bushati, Antoneta Dhima, Korab Lita, Blerina Gjylameti, Roland Xhelilaj, Reme Lala, Suzana Topi, Ylli Shehu dhe Arben Elezi.

Mungojnë:

Vullnet Sinaj, Eljo Hysko.

Të ftuar

Klajdi Karameta – Zëvendësministër i Drejtësisë

Edis Ibrahimimi – Këshilltar në Ministrinë e Drejtësisë

Artan Syziu – Përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë

Elsa Gjini – Përfaqësuese nga Ministria e Drejtësisë

Saimir Muçmataj – Drejtor i Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Vilma Causholli – Përgjegjëse në Sektorin e Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Endrit Lami – Drejtor i Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Mimoza Peço – Drejtoreshë e Operacioneve të Thesarit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Mimoza Dhemi – Drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Elsa Dhuli - Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT-it

Kesjana Halili - Sekretare e Përgjithshme e INSTAT-it

Maldi Dema - Drejtor për Koordinimin dhe Çështjet Ligjore në INSTAT

Helda Mitre - Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të IT-së në INSTAT

Ylli Merkaj – Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së

Mirela Gega – Drejtoreshë e Financave në KQZ

HAPET MBLEDHJA

Anastas Angjeli – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Sot në rendin e ditës kemi disa çështje për të shqyrtuar.

Së pari kemi miratimin e procesverbaleve të zbardhura të mbledhjeve të komisionit të datave 2 dhe 4 shkurt 2021. Çështja e dytë është shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, relatore e të cilit është deputetja Reme Lala.

Çështja e tretë është shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm dhe ankesat në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale”, relatore e të cilit është deputetja Antoneta Dhima. Çështja e katërt është miratimi i Planit Vjetor 2021 për zbatimin e programit të statistikave zyrtare 2017 – 2021, për të cilin do të jetë relator deputeti Anastas Angjeli. Në fund do të marrim një vendim për përcaktimin e fondit për subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet e vitit 2021, për të cilin do të jem po unë relator. Këto materiale ju janë vënë të gjithëve në dispozicion nëpërmjet postës suaj elektronike.

Para se të fillojmë me shqyrtimin e çështjes së parë, do të verifikojmë prezencën.

Anastasi është prezent, Arben Elezi është prezent, Antoneta Dhima është prezente, Blerina Gjylameti është prezente, Ervin Bushati nuk ka hyrë ende në linjë, Rolant Xhelilaj është prezent, Xhevit Bushaj nuk ka hyrë ende në linjë, Reme Lala është prezente, Senida është prezente, Elio Hysko nuk ka hyrë ende në linjë, Vullneti nuk ka hyrë ende në linjë, Edlira Hyseni është prezente, Krenar Ryçi është prezent, Artur Roshi nuk ka hyrë ende në linjë, Korab Lita është prezent, Ylli Shehu është prezent, Suzana Topi është prezente.

Vazhdojmë me çështjen e parë të rendit të ditës, miratimin e procesverbaleve të zbardhura të mbledhjeve të komisionit të datave 2 dhe 4 shkurt 2021. Të gjithë keni në postën tuaj elektronike procesverbalet e mbledhjeve të datave të sipërcituara. Ka ndonjë vërejtje apo sugjerim për procesverbalet? Nuk ka.

Kush është dakord? Abstenim? Kundër? Nuk ka.

Miratohen.

Vazhdojmë me çështjen e dytë të rendit të ditës, shqyrtimin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, të projektligjit “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”. Për të mbrojtur projektligjin në cilësinë e përfaqësuesve të qeverisë sot kemi në mbledhje dy përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, zotin Artan Syziu dhe zonjën Elsa Gjini.

Për shkak se në të njëjtën kohë ky projektligj po shqyrtohet edhe nga Komisioni i Ligjeve, që është përgjegjës për të, zëvendësministria, Adea Pirdeni, ndodhet në Komisionin e Ligjeve. Gjithashtu, kemi prezent përfaqësues edhe nga Ministria e Financave.

Fjalën e kanë përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë për të shpjeguar projektligjin “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”.

Klajdi Karameta – Faleminderit, zoti kryetar!

Për sa i përket projektligjit që po diskutojmë, vlen të theksohet që deri më sot Ministria e Drejtësisë, në bazë të nevojave për përkthimin zyrtar të dokumenteve që vijnë kryesisht nga vendet e huaja dhe certifikimin e tyre në gjuhën shqipe, kryesisht në fushën e të drejtës ndërkombëtare dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, ka pasur një organizim që ka mbuluar në rang kombëtar nevojën për përkthyes zyrtarë në Republikën e Shqipërisë. Ndodhur përpara nevojës më të gjerë për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar, jo vetëm atë të fushës ndërkombëtare dhe penale, ka lindur nevoja e rregullimit të këtij profesioni më gjerësisht edhe në aspekte që lidhen me dokumentacionin zyrtar të përkthyer.

Nëpërmjet nismës ligjore që është ndërmarrë synohet t’u jepet zgjidhje problematikave që lidhen kryesisht me përcaktimin e kriterëve për certifikimin e subjekteve që ushtrojnë shërbimin e përkthimit zyrtar në vend; përmirësimin e vazhdueshëm të kualifikimit të tyre profesional, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme; të drejtave dhe detyrimeve të përkthyesit zyrtar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij; ngritjes së cilësisë së ofrimit të shërbimit në përputhje me legjislacionin procedural në fuqi, si dhe mbikëqyrjen dhe kontrollin e ushtrimit të veprimtarisë së përkthyesit zyrtar nga organi certifikues, në këtë rast Ministria e Drejtësisë, duke rritur përgjegjshmërinë profesionale të këtyre subjekteve që ushtrojnë profesionin ndaj respektimit dhe zbatimit të ligjit dhe rregullave të tij.

Projektligji parashikon që çdo person që nuk certifikohet për ushtrimin e profesionit të përkthyesit zyrtar, nuk do të lejohet të kryejë këtë përkthim zyrtar të dokumenteve ose akteve normative, të miratuara në Shqipëri, as marrëveshje ndërkombëtare ose normave të nxjerra nga organizata ndërkombëtare me shkrim nga gjuha e burimit në gjuhën e synuar, si edhe të caktohet si përkthyes zyrtar nga gjykata ose prokuroritë në procese gjyqësore civile, penale, administrative, sipas parashikimeve të legjislacionit procedural në fuqi.

Kjo është një përmbledhje e shkurtër e synimit të Ministrisë së Drejtësisë, në paraqitjen e nismës para Parlamentit. Kolegët e drejtorisë së kodifikimit, janë në dispozicion për ndonjë pyetje që komisioni do ta vlerësojë se duhet të shqyrtohet më në detaje ose diçka të kësaj natyre.

Ju faleminderit, zoti kryetar!

Anastas Angjeli – Zonja Peço, nga Ministria e Financave, keni ndonjë koment?

Mimoza Peço – Është futur në linjë, Saimiri i drejtorisë së legjislacionit.

Anastas Angjeli – Saimir, keni ju ndonjë koment?

Saimir Muçmataj – Më falni, se pata disa probleme teknike.

Më falni, çfarë ishte, se nuk e ndoqa?

Anastas Angjeli – Po ti e di përse ke ardhur?

Saimir Muçmataj – Për ligjin “Për përkthimin zyrtar”.

Anastas Angjeli – Po, pra. Na thuaj ndonjë gjë, nga këndvështrimi juaj, si përfaqësues i Ministrisë së Financave, se Ministria e Drejtësisë e bëri prezantimin.

Saimir Muçmataj – Ne nuk kemi ndonjë gjë.

Anastas Angjeli – S’keni ndonjë gjë. S’ka si të kesh, se tani e more vesh.

Faleminderit!

Fjala për relatoreen Reme Lala.

Reme Lala - Faleminderit, zoti kryetar!

Dëgjohem besoj?

Anastas Angjeli – Po.

Reme Lala - Projektligji “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar” është propozuar nga Këshilli i Ministrave dhe Komisioni i Ekonomisë dhe Financave e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi.

Këshilli i Ministrave e ka propozuar projektligjin bazuar në nenet 78 dhe 83, pika 1 e Kushtetutës dhe, gjithashtu, është shoqëruar me relacionin përkatës, sipas kërkesave të nenit 68 të Rregullore së Kuvendit.

Për sa i përket qëllimi të projektligjit, qëllimi i projektligjit është përcaktimi i rregullave për ushtrimin e veprimtarisë së përkthimit zyrtar në vendin tonë, për të siguruar mirëfunksionimin e tij, si dhe mbrojtjen dhe garantimin e subjekteve që ushtrojnë këtë profesion.

Aktualisht, ka një boshllëk ligjor për rregullimin e profesionit të përkthimit zyrtar dhe veprimtaria e përkthimit zyrtar rregullohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, nr.3165, datë 12.05.2004 “Për kriteret procedurat e përzgjedhjes dhe

tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm, si dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, të ndryshuar””. Ky udhëzim përcakton kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm nga Ministria e Drejtësisë, tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm dhe tarifat që duhet të paguajnë të tretët.

Mungesa e ligjit dhe nevoja për zgjerimin e fushës së përkthimit zyrtar dhe ndryshimet që kanë ndodhur në legjislacionin e vendit tonë, sollën nevojën për hartimin e këtij projektligji. Plotësimi i kuadrit ligjor, për përkthimin zyrtar është kërkuar, gjithashtu, edhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për të pacaktuar profesionistë mbi bazën e meritokracisë, për shërbime përkthimi sa më cilësore dhe një veprimtari të rregulluar me akte ligjore. Përkthimi zyrtar është mjaft i rëndësishëm për veprimtarinë e Ministrisë së Drejtësisë në fushën e marrëdhënieve ligjore me autoritetet e huaja, si dhe në procesin hetimor dhe gjyqësor ndaj hartimi i këtij projektligji është i domosdoshëm.

Nga ana tjetër, projektligji është në përputhje me parashikimet dhe politikat e Këshillit të Ministrave për përmirësimin e shërbimit të përkthimit zyrtar.

Gjithashtu, projektligji parashikon rregulla të hollësishme lidhur me certifikimin e profesionit të përkthyesit zyrtar dhe interpretit të gjuhës së shenjave, kriteret e përzgjedhjes së përkthyesve zyrtar, mbikëqyrjen nga Ministri i Drejtësisë dhe sanksione për raste e shkeljes së ligjit.

Gjithashtu, projektligji mundëson një përafrimin me direktivën 2010/64 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 20 tetor 2010, për të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procedurat penale.

Ky përafrim bëhet për ruajtjen e konfidencialitetit nga përkthyesit zyrtarë dhe interpretët e gjuhës së shenjave, si dhe për krijimin e një regjistri të veçantë për përkthyesit zyrtarë dhe interpretët.

Gjithashtu, një nga risitë e projektligjit është krijimi i regjistrit elektronik të përkthyesve zyrtarë dhe interpretëve të gjuhëve të shenjave. Ky regjistër krijohet dhe administrohet nga Ministria e Drejtësisë.

Mund të përmend, gjithashtu, edhe përzgjedhjen e përkthyesve zyrtarë për çdo gjuhë të huaj, si dhe të interpretëve të gjuhës së shenjave, e cila do të kryhet nëpërmjet provimit të kualifikimit, që do të organizohet nga Ministria e Drejtësisë një herë në dy vjet. Për vlerësimin e rezultateve të provimit ngrihen dy komisione të posaçme, njëri për përzgjedhjen e përkthyesve zyrtarë dhe tjetri për përzgjedhjen e interpretëve të gjuhës së shenjave. Ndërkohë, komisioni i posaçëm për përzgjedhjen e përkthyesve zyrtarë përbëhet nga përfaqësues së Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Arsimit dhe institucioneve të arsimit të lartë. Gjithashtu, komisioni i

posaçme, për përzgjedhjen e interpretëve të gjuhës së shenjave, përbëhet nga përfaqësues së Ministrisë së Drejtësisë, ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen sociale dhe interpretëve të gjuhës së shenjave.

Ndërkohë, për efektet financiare të projektligjit në buxhetin e shtetit për vitin 2021 përafërsisht janë 1,4 milionë lekë, në vitin 2022, 71,3 milionë lekë dhe në vitin 2023 8 milionë lekë.

Regjistri elektronik i përkthyesve zyrtarë parashikohet të ngrihet në viti 2022. Ndërkohë, projektligji është shumë i rëndësishëm, pasi krijon për herë të parë bazën ligjore për shërbimin e përkthimit zyrtar dhe ushtrimin e profesionit të përkthyesit zyrtar në vendin tonë dhe ky projektligj do të ndihmojë në zgjerimin e kuadrit të përkthimit zyrtar, në rritjen e cilësisë së këtij shërbimi, si dhe në mbrojtjen e subjekteve që ushtrojnë këtë profesion. Krijimi i regjistrit elektronik të përkthyesve zyrtarë do të ndihmojë në rritjen e saktësisë dhe cilësisë së informacionit lidhur me përkthyesit zyrtarë, aksesimin e tij në çdo kohë, si dhe përmirësimin e menaxhimit të procesit të përzgjedhjes së përkthyesve zyrtarë.

Automatizimi i procesit të përkthyesit zyrtar, është pjesë e automatizimit të proceseve në administratën publike, që po kryhet vitet e fundit dhe do të përmirësojë ndjeshëm shkallën e informacionit dhe të menaxhimit të tij, si dhe të ndërveprimit midis institucioneve të ndryshme.

Efektet financiare, siç i përmenda, janë të përfshira në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2021, ndërsa për vitet 2022 dhe 2023, do të planifikohen nga AKSH-i në PBA-në 2022-2024, me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë.

Mbështetur në argumentet e mësipërm, i propozoj komisionit miratimin e projektligjit.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zonja Lala!

Para se të vazhdojmë me pyetje dhe me ndonjë diskutim që mund të ketë rreth kësaj çështjeje, ju bëj me dije se janë futur në mbledhje deputetët Ervin Bushati, Xhevit Bushaj, Eljo Hysko, Vullnet Sinaj, Artur Roshi dhe Suzana Topi. Janë prezentë? E dëgjuan emrin.

Faleminderit!

Ka njeri pyetje rreth projektit të paraqitur? Edlira.

Edlira Hyseni – Mundem?

Mirëdita!

Faleminderit, zoti kryetar!

Ky është një ligj i ri që besoj, si ligjet e tjera që kanë rregulluar fushën e profesioneve të lira, vjen për të përmirësuar edhe profesionin e lirë të përkthyesit zyrtar. Unë kisha dy-tri pyetje lidhur me nenet përkatëse, konkretisht nenet 9, 11 dhe 14.

Pyetja e parë lidhet me papajtueshmëritë. Në nenin 9 përcaktohet që ky profesion, pra profesioni i disiplinuar me ligjin e ri, i përkthyesit zyrtar ka papajtueshmëri me çdo detyrë apo funksion tjetër. Është thënë thjesht që nuk mund të kryejë njëkohësisht funksione apo detyra të tjera, të cilat ndalohen me ligje të veçanta. Çfarë kemi konkretisht? Dua të di, nëse sot një noter e bën edhe përkthyesin ose mund të ketë dy licenca apo një profesion tjetër dhe mund të ushtrojë dy a më shumë shërbime të tilla, mund ta bëjë, apo ekskluzivisht duhet të bëjë vetëm përkthyesin? Pra, dua ta kuptoj më mirë nenin që lidhet me papajtueshmëritë.

Pyetja e dytë lidhet me tarifatat, për të cilat thuhet që do të përcaktohen me udhëzime. A kemi ndonjë projekt, ndonjë ide pak a shumë se cilat janë tarifatat e parashikuara ose të menduara për t'u implementuar me këtë ligj, që do të jenë, në fakt, jo vetëm në interesin e institucioneve, siç është Ministria e Drejtësisë, por edhe në interesin e çdo qytetari që ka të bëjë me përkthimet në jetën e përditshme? Janë veprimtari që të gjithë në bashkërisht i ndeshim në nevojat tona të përditshme. Kështu që do të doja ndonjë informacion shtesë lidhur me tarifatat.

Pyetja tjetër: si do të veprohet me përkthyesit aktualë, ata që tashmë në këto vite dhe në këtë moment e ushtrojnë në mënyrë të rregull këtë profesion? Edhe ata do t'i nënshtrohen provimit kualifikues apo ricertifikimit? Domethënë, dua të di si është menduar rregullimi i përkthyesve aktualë me ligjin e ri: duhet të bëjnë testime të reja, duhet të rilicencohen? Çfarë kushtesh kanë përkthyesit aktualë, apo do të jenë të përjashtuar nga kushtet që kërkon ligji i ri për të hyrë në tregun e këtij profesioni të lirë? Pra, si është rregulluar kjo pikë?

Kam edhe një pyetje në lidhje me neni 14 "Kriteret e ushtrimit të profesionit", ndër të cilat thuhet: "Të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës apo funksioni publik për arsye të integritetit etik". A ka një afat të përcaktuar? Çfarë kuptohet me këtë? Sepse mund të jenë raste nga më të ndryshmet dhe të penalizosh një individ nga mundësia për ta ushtruar këtë profesion për ndonjë masë disiplinore etike, që mund të jetë marrë në ndonjë funksion? Ose duhet të jetë pak më e qartë çfarë ka parasysh, ose duhet vënë një afat, ku e di unë, tre vjetët e fundit apo për një periudhë të limituar kohore, në mënyrë që të mos jetë pafundësisht i penalizuar me një lloj mase që, ndoshta, ka qenë relative apo subjektive.

Këto pyetje kisha. Gjithsesi, rregullimin e profesioneve të lira me ligje të posaçme e mbështes dhe shpresoj të sjellë përmirësime edhe në këtë treg shërbimesh.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, Edlira!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Meqenëse jo, kam unë dy pyetje.

E para, ku jeni bazuar që keni vendosur tarifatat e anëtarëve të komisionit dhe të kryetarit të komisionit që për çdo mbledhje, që do të zhvillohet, shpërblimi është 7 mijë lekë për anëtarët dhe 8 mijë për kryetarin, duke llogaritur që do të jenë 12 mbledhje në vit, për arsye se keni përcaktuar që rregullisht do të mbledhen 1 herë në muaj? Keni ndonjë krahasim me komisione të tjera të ngjashme me këto?

Pyetja e dytë ka të bëjë me koston e regjistrimit elektronik të përkthyesve. A keni ndonjë referencë me koston e regjistrave të tjerë që përdoren sot (shumë të ngjashme me të përkthyesve nuk ka, në fakt, se është shumë e thjeshtë, por me të tjerët), ku jeni bazuar dhe e keni vendosur atë?

Faleminderit!

Besoj se për këto do të përgjigjen përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, apo të Ministrisë së Financave?

Sipas radhës, fjala është për përfaqësuesit e qeverisë.

Klajd Karameta – Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegët e Kodifikimit janë më në detaje. Ju lutem, Elsa dhe Artan, përgjigjuni pyetjeve.

Elsa Gjini – Përshëndetje të gjithëve!

Për sa i takon pyetjes së parë lidhur me papajtueshmërinë e ushtrimit të këtij profesioni, në fakt, në nenin 9, pika 1, parashikohet që përkthyesi zyrtar nuk mund të kryejë njëkohësisht funksion apo detyra të tjera, të cilat ndalohen me ligje të veçanta.

Nisur nga interpretimi që ne mund t'i bëjmë kësaj dispozite, kjo parashikon që, në rast se, për shembull, ligji i noterisë apo ligji i përmbarimit, pra profesione të tjera të cilat janë të rregulluara me ligje të veçanta, të mirëstrukturuara, parashikojnë ndalimin e ushtrimit të këtij profesioni paralelisht me profesionin e përkthimit zyrtar, normalisht që përkthyesi zyrtar e ka të ndaluar që ta ushtrojë këtë lloj veprimtarie. Pra, në rast se atij i ndalohet me ligje të veçanta ushtrimi i këtij profesioni, ai e ka të pamundur dhe gjendet në kushtet e papajtueshmërisë së plotë për ushtrimin e këtij profesioni. Pra, është ndalim ligjor ekskluziv.

Lidhur me pyetjet e tjera do të vijojë kolegu im, zoti Syziu.

Faleminderit!

Artan Syziu – Përshëndetje!

Për sa u përket tarifave të shërbimit lidhur me kryerjen e aktivitetit të shërbimit të përkthimit zyrtar, pra përkthyesve të certifikuar, nëse do t'i referohemi nenit 11 të projektligjit,

është parashikuar që kjo do të nxirret me një akt nënligjor midis ministrit të Drejtësisë dhe ministrit

të Financave dhe të Ekonomisë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Edhe në takimin e zgjeruar për prezantimin e projektligjit, që bëri ministrja Drejtësisë me komunitetin e përkthyesve, si pjesë e konsiderueshme e komunitetit të përkthyesve, u kërkua nga komuniteti i përkthyesve që tarifatat që ata aplikojnë, të cilat nuk janë zyrtare, janë shumë të ulëta. Kështu, u pranua sugjerimi i komunitetit të përfaqësuesve të përkthyesve, aktualisht zyrtar, që tarifatat të jenë objekt i ndryshimeve dhe i rishikimeve të tyre me miratimin e ligjit dhe është lënë një dispozitë e përgjithshme që këto do të miratohen me akt nënligjor pas hyrjes në fuqi të ligjit të përkthyesve zyrtarë dhe shërbimit të përkthyesve zyrtarë. Ky parashikim i tillë është ngjashëm me aktet e tjera nënligjore me një pjesë të avokatisë apo me dhomat e të tjera kombëtare, që kryesisht nxirren me udhëzime të përbashkëta të ministrit të një fushe përkatëse me ministrin e Financave.

Për sa u përket subjekteve që janë aktualisht të licencuara, ligji fillimisht ka qenë për licencimin e përkthyesve zyrtarë, por me sugjerimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit, si institucion varësie i Ministrisë së Financave, interpretimi i legjislacionit sektorial të Qendrës Kombëtare të Biznesit u sugjerua që të ketë certifikatë dhe të mos ketë licencim, por qëllimi është i njëjtë: formalizimi i këtij lloj tregu dhe i këtij lloj shërbimi.

Ndërsa për përkthyesit aktualë të licencuar, pra që janë të licencuar apo të certifikuar nga Ministria e Drejtësisë, atyre automatikisht do t'u njihet licenca dhe do të konsiderohen përkthyes të certifikuar.

Në qoftë se do t'i referohemi nenit 44 të projektligjit në paragrafin e parë thuhet: “Të gjitha subjektet, që janë të licencuara ose të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë (sepse në vite të ndryshme janë përdorur dy terma “autorizim” dhe “licencim”, siç e thashë, pasi nuk ka pasur një ligj të veçantë, por ka qenë një udhëzim i Ministrit të Drejtësisë i shumë viteve të mëparshme) si përkthyes zyrtarë, konsiderohen *ipso lege* të certifikuar për ushtrimin e veprimtarisë së përkthimit zyrtar, sipas parashikimeve të këtij ligji.” Pra, automatikisht këtyre përkthyesve do t'u njihet licenca dhe autorizimi i dhënë nga Ministria e Drejtësisë, në bazë të konkurseve përkatëse që ata kanë bërë ndër vite.

Elsa Gjini – Dua të shtoj diçka për këtë pjesë. I vetmi detyrim që parashikohet për përkthyesit, që aktualisht ushtrojnë veprimtarinë e tyre, është të paraqesin një kërkesë pranë Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet së cilës duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin për t'u

regjistruar në regjistrin e përkthyesve zyrtarë, të cilët parashikohen në këtë projektligj, në të kundërt parashikohet aplikimi i penalistëve përkatëse. Pra, detyrimi i përkthyesve zyrtarë, të cilët ushtojnë aktualisht veprimtarinë e tyre, është paraqitja e kërkesës pranë Ministrisë së Drejtësisë, regjistrimi i tyre në regjistrin elektronik dhe pajisja me certifikatën përkatëse që nënkupton vijimin e ushtrimit të këtij profesioni.

Artan Syziu – Për sa u përket pyetjeve lidhur me tarifat e anëtarëve të komisionit dhe tarifat e mirëmbajtjes së regjistrit, që i përkasin aspektit financiar, janë konsultuar nga Drejtoria e Financave e Ministrisë së Drejtësisë së bashku me Ministrinë e Financave. Pjesa e shpenzimeve financiare që shoqëron hartimin e këtij projektligji, janë modalitete që janë konsultuar dhe janë bashkërenduar në finale të tyre me Ministrinë e Financave dhe me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, AKSHI-n, pra për mirëmbajtjen e regjistrit dhe për shpërblimin e komisionerëve, të anëtarëve të komisionit të disiplinës apo të komisionit të certifikimit që merret me testimin e përkthyesve.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit për përgjigjet!

Elsa Gjini – A mund të shtoj diçka, ju lutem?

Anastas Angjeli – Para se ju të shtoni diçka, kam unë për të shtuar diçka. Zonja Edlira bëri një pyetje për sa i përket mënyrës së shpërblimit të përkthyesve, të cilën e keni vendosur që do ta bëni me udhëzim. Aktualisht si po procedohet?

Artan Syziu – Aktualisht është me udhëzim të veçantë të ministrit të Drejtësisë. Këtu bëhet fjalë vetëm për përkthyesit e kontraktuar nga Ministria e Drejtësisë, jo për përkthyesit që veprojnë në tregun jashtë fushës së juridiksionit të Ministrisë së Drejtësisë, pra që punojnë me noterët....

Anastas Angjeli – Ligji i ri nuk besoj se bën fjalë vetëm për përkthyesit që do të kontraktohen nga Ministria e Drejtësisë, apo jo? Ky është ligj i përgjithshëm për të gjithë përkthyesit që do të kontraktohen nga institucionet e ndryshme. Pra, a do të vlejë udhëzimi që keni nxjerrë ju, apo do të dalë një udhëzim i ri?

Elsa Gjini – Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, normalisht që do të dalë një udhëzim i ri, i cili do të jetë i përbashkët me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe do të rregullojë pikërisht çështjen e shpërblimeve të përkthyesve zyrtarë.

Anastas Angjeli – A jeni të sigurt se tarifat do t'i caktoni me udhëzim?

Elsa Gjini – Po, duke pasur parasysh edhe modelet në legjislacionet apo në ligje të tjera të veçanta, që kanë rregulluar pikërisht profesione të tilla, është menduar dhe është vlerësuar që

të bëhet me udhëzim të përbashkët me Ministrinë e Financave, e cila ka shprehur dakordësinë dhe nuk ka pasur kundërshtime lidhur me këtë çështje.

Anastas Angjeli – Në rregull!

Atëherë, çfarë kishit për të shtuar ju?

Elsa Gjini – Kisha diçka në lidhje me pyetjen që ju bëtë për sa u takon modeleve që janë marrë lidhur me shpërblimin e anëtarëve të komisionit, qoftë të komisionit të kualifikimit apo qoftë edhe të komisionit disiplinor. Lidhur me shpërblimin e tyre, ne kemi marrë si model shpërblimet që janë pikërisht për anëtarët e komisionit disiplinor të bordit disiplinor dhe të komisionit të kualifikimit për noterët, pra për provimin e kualifikimit për noterët dhe komisionit disiplinor për procedimet që ndiqen ndaj noterëve. Pra, kemi marrë këtë model të ngjashëm.

Anastas Angjeli – A keni pyetje apo diskutime të tjera? Nuk ka.

Atëherë, kalojmë në votimin e projektligjit “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”.

E hedhim në votim në parim projektligjin.

Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? 4 abstenime.

Miratohet projektligji me shumicë votash, me katër abstenime dhe 1 votë kundër.

Fillojmë miratimin e projektit, meqenëse ka shumë nene, nëse do të ketë abstenim dhe kundër në të gjitha nenet, do të më lejoni që të mos e përmend vazhdimisht.

Neni 1. Kush është dakord me nenin 1? Faleminderit! Kundër? 1 votë, zoti Lita. Abstenim? 4 vota, si gjithnjë.

Miratohet me shumicë votash.

Neni 2. Kush është dakord? Faleminderit! Kundër? 1 votë. Abstenim? 4 vota si gjithnjë.

Miratohet me shumicë votash.

Kështu do të jeni për të gjitha nenet? Dakord, faleminderit!

Miratohet me shumicë votash.

Neni 3. Kush është dakord? Faleminderit! Kundër? 1 votë. Abstenim? 4 vota.

Miratohet me shumicë votash.

Neni 4. Kush është dakord? Faleminderit! Kundër? 1 votë. Abstenim? 4 vota.

Miratohet me shumicë votash.

(Nga neni 4 deri te neni 18 miratohen me të njëjtën mënyrë votimi)

Neni 19. Kush është dakord? Faleminderit! Kundër? 1 votë. Abstenim? 4 vota.

Miratohet me shumicë votash.

Kreu i IV “Pezullimi, heqja e certifikatës dhe çregjistrimi nga regjistri elektronik”.

Neni 20 “Pezullimi i përkohshëm me kërkesë”. Kush është dakord? Kundër? 1 votë.
Abstenim? 4 vota.

Miratohet me shumicë votash.

Neni 21 “Pezullimi nga detyra për shkaqe të tjera”. Faleminderit! Kundër? 1 votë.
Abstenim? 4 vota.

Miratohet me shumicë votash.

Nga neni 22 “Çregjistrimi nga regjistri elektronik”. Kush është dakord? Faleminderit!
Kundër? 1 votë. Abstenim? 4 vota.

Miratohet me shumicë votash.

Kreu i V “Të drejtat dhe detyrimet”.

Neni 23 “Kujdesi në ushtrimin e veprimtarisë”. Kush është dakord? Faleminderit!
Kundër? 1 votë. Abstenim? 4 vota.

Miratohet me shumicë votash.

(Nga neni 23 deri te neni 37 miratohen me të njëjtin mënyrë votimi)

Neni 38 “Vendimmarrja e komisionit disiplinor për çështjet disiplinore”.

Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? 4 abstenim.

Miratohet me shumicë votash.

Faleminderit!

Kreu i VII, “Shkeljet dhe masat disiplinore”.

Neni 39 “Shkeljet dhe masat disiplinore”.

Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? 4 abstenim.

Miratohet me shumicë votash.

Faleminderit!

Neni 40 “E drejta e ankimit për masat disiplinore”.

Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? 4 abstenim.

Miratohet me shumicë votash.

Faleminderit!

Neni 41 “Ekzekutimi i vendimit”.

Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? 4 abstenim.

Miratohet me shumicë votash.

Faleminderit!

Neni 42 “Regjistrimi i masave disiplinore”.

Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? 4 abstenim.

Miratohet me shumicë votash.

Faleminderit!

Kreu i VIII “Dispozita kalimtare dhe të fundit”.

Neni 43 “Aktet nënligjore”.

Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? 4 abstenim.

Miratohet me shumicë votash.

Faleminderit!

Neni 44 “Dispozitë kalimtare”.

Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? 4 abstenim.

Miratohet me shumicë votash.

Faleminderit!

Neni 45 “Penalitetet”.

Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? 4 abstenim.

Miratohet me shumicë votash.

Faleminderit!

Neni 46 “Shfuqizime”. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? 4 abstenim.

Faleminderit!

Miratohet me shumicë votash.

Neni 47 “Hyrja në fuqi”.

Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? 4 abstenim.

Miratohet me shumicë votash.

Faleminderit!

Votojmë projektligjin në tërësi.

Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? 4 abstenim.

Miratohet me shumicë votash projektligjit "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar".

Faleminderit të gjithëve!

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.2.2021, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, i projektligjit "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale"

Marrin pjesë:

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Xhevit Bushaj, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Krenar Ryci, Ervin Bushati, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Korab Lita, Blerina Gjylameti, Roland Xhelilaj, Reme Lala, Suzana Topi, Ylli Shehu, Arben Elezi,

Mungojnë:

Vullnet Sinaj, Eljo Hysko,

Të ftuar:

Klajd Karameta – Zëvendësministër i Drejtësisë

Edis Ibrahim – Këshilltar në Ministrinë e Drejtësisë

Artan Syziu – Përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë

Elsa Gjini – Përfaqësuese nga Ministria e Drejtësisë

Saimir Muçmataj – Drejtor i Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Wilma Çausholli – Përgjegjëse në Sektorin e Analizës dhe Programimit Buxhetor, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Endrit Lami – Drejtor i Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale - në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Peco – Drejtoreshë e Operacioneve të Thesarit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhembli – Drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

...

Anastas Angjeli – Kalojmë në çështjen e tretë, shqyrtimin e projektligjit "Për shërbimin e kontrollit të brendshëm dhe ankesat në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale", në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi.

Për të mbrojtur projektligjin me cilësinë e përfaqësuesve të qeverisë, kemi sot të ftuar përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, Klajdi Karameta, zëvendësministër dhe zotin Edis Ibrahim, këshilltar.

Nga Ministria e Financave kemi Vilma Caushollin, ju lutem të gjithë të bëhen prezent dhe të ndezin videot.

Për projektligjin "Për shërbimin e kontrollit të brendshëm dhe ankesat në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale", ne jemi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi.

Relatore është zonja Antoneta Dhima.

Fjalën e ka përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë.

Klajdi Karameta – Faleminderit, zoti kryetar!

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve është institucioni në vartësi me numrin më të madh të punonjësve pranë Ministrisë së Drejtësisë, me rreth 3500 punonjës dhe rreth 5 mijë të dënuar, një strukturë e relativisht e madhe e sistemit. Në këtë pikëpamje, projektligji që keni përpara paraqet një përparësi të dukshme për legjislacionin aktual, pasi konsolidon praktikën e shërbimit, i cili funksionon si një mekanizëm për parandalimin e goditjes së veprimtarisë së kundërligjshme në radhët e strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, dhe, së fundi, edhe atë të Drejtorisë së Përgjithshme të Provës.

Projektligji synon një reformim të shërbimit duke u organizuar si strukturë e veçantë e Ministrisë së Drejtësisë, në varësi të drejtpërdrejtë të ministrit, i cili ka kompetenca hetimore dhe gjurmuese, përveç veprimtarisë informative.

Shërbimi transformohet drejt një modeli më demokratik, si në aspektin e misionit, edhe të detyrave funksionale, përgjegjësi, strukturës dhe personelit, duke marrë njëkohësisht edhe atributet e Policisë Gjyqësore.

Shërbimi funksionon si një mekanizëm për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë së kundërligjshme në strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, si dhe Policisë së Burgjeve, të cilat kanë si objekt ekzekutimin apo vënien në ekzekutim të vendimeve penale dhe urdhrave të tjerë ligjorë apo mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve plotësuese në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

Projektligji ka risi përshtatjen e kërkesave të kohës dhe disa parimeve bazë, mbi të cilat operojnë sot agjencitë e zbatimit të ligjit në fushën e parandalimit, zbulimit, hetimit të veprave penale, si dhe shkeljeve të ligjit të kryera nga punonjësit e strukturave policore të burgjeve dhe strukturave të ekzekutimit dhe vendimeve penale gjatë ushtrimit të detyrës, dhe për shkak të saj, si dhe mundëson një kontrollim të zbatimit të dispozitave të ligjit në fushën e të drejtave dhe trajtimit të të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve. Konkretisht fushat ku ndërhyhet kryesisht janë fusha ku zgjerohet dukshëm objekti i veprimtarisë së shërbimit, duke përfshirë trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave të publikut, kontrollin e pasurisë së pajustificueshme të personave objekt hetimi, garantohet ruajtja e integritetit të punonjësve dhe veprimtaria kërkimore, me qëllim dhënien e rekomandimeve dhe sugjerimeve për përmirësimin në aspekte të organizimit dhe funksionimit të strukturave së pritshmërisë së publikut me operatorë të rendit dhe sigurisë. Përcakton si kritere thelbësore përzgjedhjen e drejtuesit të shërbimit, karakterin e tij etik dhe moral, pavarësinë politike, pavarësinë në drejtimin e strukturave që mbikëqyren dhe kontrollohen, duke garantuar zbatimin e parimeve të pavarësisë dhe depolitizimin e shërbimeve. Nga ky projektligj përcaktohet më mirë fusha e veprimit të veprimtarisë së tij informuese, gjurmuese dhe hetimore, duke i dhënë atributet e Policisë Gjyqësore.

I kushton vëmendje të veçantë trajtimit e shqyrtimit të ankesave të të paraburgosurve, të dënuarve dhe qytetarëve. Zgjeron kompetencat e mbikëqyrjes, çka rezulton si një mjet i dobishëm në përjasjen proaktive të hetimit të korrupsionit dhe shkeljeve të tjera të ligjit. Përcakton ndarjen e personelit në dy kategori, personeli operacional dhe personeli administrativ. Përcakton qartë pavarësinë financiare të shërbimit në mënyrë taksative se buxheti i shërbimit është zë më vete në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë. Këto janë disa nga risitë dhe synimet që ndiqen nga projektligji.

Për ndonjë pyetje më të detajuar është Edis Ibrahim, i cili mund t'u japë kolegëve të komisionit një shpjegim më të hollësishëm.

Ju faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Fjalën e ka relatorja e projektit, Antoneta Dhima.

Fjala për ju, Antoneta.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj zotin zëvendësministër për prezantimin e këtij projektligji!

Ashtu si e thatë dhe ju Komisioni për Ekonominë dhe Financën e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi.

Ky projektligj ka për qëllim përcaktimin e misionit, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesave në Sistemin e Ekzekutimit të

Vendimeve Penale, si dhe përcakton statusin, karrierën, të drejtat dhe detyrat e përgjegjësitë e punonjësve të këtij shërbimi.

Misioni i këtij shërbimi do të jetë garantimi i zbatimit të ligjit nga punonjësit e strukturave, me qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetit dhe të të drejtave themelore të njeriut, nga veprimet, ose mosveprimet e kundërligjshme të tyre. Ky projektligj synon të mundësohet zhvillimi i kapaciteteve dhe forcimi i funksionit të shërbimit, me qëllim garantimin e respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të individit, të transparencës, të kontrollit të brendshëm e të jashtëm civil, përqasjes proaktive, afrimit të tij më pranë qytetarit dhe aktivizimi i kontrollit civil ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe të Policisë së Burgjeve, përshtatja e shërbimit me ndryshimet bashkëkohore të shërbimeve homologe, gjë që e theksoi edhe zëvendësministri, shtimit të veprimtarive dhe të kompetencave ligjore, instrumenteve, teknikave, formave e metodave ligjore për krijimin e produkteve të antikorrupsionit. Disa nga risitë u thanë edhe nga zëvendësministri.

Projektligji zgjeron fushën e misionit të shërbimit nëpërmjet garantimit të zbatimit të ligjit dhe interesave të taksapaguesve shqiptarë, por edhe mbrojtjen e veprimtarisë së mundshme kriminale dhe të kundërligjshme të kryer nga çdo punonjës në struktura pavarësisht nga funksioni që kanë. Zgjeron dukshëm objektin e veprimtarisë së shërbimit, duke përfshirë trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave të publikut, kontrollin e pasurive të pajustificueshme të personave objekt hetimi, ruajtjen e integritetit të punonjësve, si dhe veprimtarinë kërkimore me *(nuk dëgjohet)* dhe funksionimit të strukturave dhe pritshmërisë së publikut në kuadër të rendit e sigurisë në burgje. Gjithashtu ai vendos disa kritere të rëndësishme lidhur me përzgjedhjen e drejtuesit të tij, duke u fokusuar te kryesorja, pra integriteti i figurës, paaënësia politike dhe çështje të tjera. Gjithashtu, projektligji përcakton më mirë fushat e veprimtarisë informative, gjurmuese dhe asaj hetimore, duke i dhënë atributet e Policisë Gjyqësore dhe vë në fokus trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave të të paraburgosurve, të dënuarve dhe të qytetarëve. Zgjeron

kompetencat e mbikëqyrjes, përcakton ndarjen e personelit në dy kategori, personel operacional dhe personel administrativ, si dhe përcakton mundësitë e buxhetit si një zë i vetëm në buxhetin e shtetit dhe të tjera.

Ndryshe nga legjislacioni aktual në fuqi projektligji konsolidon dhe reformon dukshëm praktikën e shërbimit, kryesisht në organizimin e kësaj strukture në transformimin e shërbimit drejt një modeli demokratik, fokusimi në faktin që shërbimi të funksionojë si një mekanizëm për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë së kundërligjshme.

Projektligji ka si objekt reformimin e shërbimit si një mekanizmi thelbësor në luftimin dhe parandalimin e veprimtarisë së kundërligjshme në radhët e strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe të Policisë Gjyqësore, duke e përshtatur plotësisht këtë me kërkesat e kohës dhe ndryshimet bashkëkohore të shërbimeve homologe.

Në fakt, projektligji ka për qëllim gjithashtu të mundësojë edhe një qasje proaktive, afrimin e tij më pranë qytetarëve, aktivizimin e kontrollit civil ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe të Policisë Gjyqësore, si dhe parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe hetimin paraprak të veprimtarisë kriminale dhe korruptive (*nuk dëgjohet*) në sistemin e ekzekutimeve të vendimeve penale. Njëkohësisht, veprimtaria e kësaj strukture do të udhëhiqet nga disa parime, siç janë: ligjshmëria; mbrojtja e sekretit hetimor, si dhe e informacionit të klasifikuar; ruajtja e konfidencialitetit dhe proporcionaliteti; drejtësia dhe paanësia; respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe kontrolli i llogaridhënieve.

Në fakt, ashtu si dhe për ligje të tjera, edhe për këtë ligj është bërë e domosdoshme që të pësojë ndryshimet dhe të bëhet një ligj i ri, për shkak të vakumeve ligjore që janë konstatuar. Unë nuk po ndalem tek këto vakume ligjore, sepse ne, si Komisioni Ekonomik, e studiojmë projektligjin nga pikëpamja financiare.

Ajo që duhet theksuar është se ky projektligj është përgatitur nga një grup pune me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Burgje, si dhe ekspertë të kontraktuar nga ambasada britanike.

Projektligji i është nënshtruar procesit të konsultimit në portalin e regjistrimit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike, njëkohësisht, është bërë një diskutim në tryezë me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, për konsultimin e projektligjeve të sistemit penitenciar.

Për sa u përket efekteve financiare, dua të theksoj faktin që Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale aktualisht është ngritur dhe është funksionale. Ajo është organizuar në katër sektorë me 23 punonjës. Pranë të gjitha IEVP-ve, shërbimi ka të atashuar nga një inspektor dhe në total në të gjitha IEVP-të janë atashuar rreth 36 punonjës, që punojnë për llogari të këtij shërbimi. Këta punonjës aktualisht janë të përfshirë në strukturat e IEVP-ve.

Për shkak të ligjit që ne po diskutojmë sot dhe në kushtet e riorganizimit të strukturës dhe forcimit të këtij shërbimi, është bërë dhe rivlerësimi i...*(Nuk dëgjohet)* janë aktualisht pranë IEVP-ve, do të atashohen në strukturë, për shkak se fondi respektiv i pagesave do të kalojë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në fondin e pagave të këtij shërbimi. Kjo procedurë nuk shkakton shpenzime financiare, por bëhet vetëm transferimi i tyre. Ndërkohë, këtij shërbimi i janë atashuar 14 punonjës shtesë nga numri i përgjithshëm i punonjësve të Ministrisë së Drejtësisë, miratuar me ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, duke e çuar numrin në 73 punonjës.

Efektet financiare, që lidhen me fondin e pagave për 14 punonjës shtesë, janë llogaritur nga kjo ministri dhe shkojnë në vlerën rreth 18,8 milionë lekë në vit.

Për sa u takon shpenzimeve kapitale, shpenzimeve për mallra e shërbime dhe fondit të posaçëm, janë bërë përlllogaritjet, konkretisht: 5 milionë lekë për investime, kryesisht për pajisje kompjuterike, pajisje zyre për punonjësit e shtuar dhe pajisje speciale hetimi; 6 milionë lekë për shpenzime mallra e shërbime për funksionimin normal të institucionit, që do t’u shërbejë 73 punonjësve.

Fondi i posaçëm parashikohet të jetë 1 milion lekë. Aktualisht është planifikuar një fond prej 100 mijë lekësh në zërin mallra dhe shërbime, por që nuk është përdorur në asnjë rast.

Efektet financiare në zërin nr. 602 “Mallra e shërbime” dhe “Transferta tek individët” llogariten në masën 7 milionë lekë në vit dhe do të përballohen nga fondet e parashikuara në PBA-në e sistemit të burgjeve.

Duke vlerësuar se miratimi i këtij projektligji konsolidon praktikën e këtij shërbimi ose krijimin e këtij shërbimi të ri, i cili është duke funksionuar si një mekanizëm për parandalimin e goditjes së veprimtarisë së kundërligjshme në radhët e strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Policisë së Burgjeve, si dhe, së fundi, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, të nderuara kolege dhe kolegë deputetë, ju ftoj ta miratojmë atë.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Antoneta Dhima – Zoti kryetar, meqenëse kam fjalën, a mund të bëj dhe dy pyetje?

Anastas Angjeli – T’i kishe bërë.

Antoneta Dhima – Faleminderit!

Në relacionin që i bashkëngjitet projektligjit përcaktohet si risi e projektligjit krijimi i pavarësisë financiare të shërbimit. Pyetja imë është: çfarë keni në konsideratë me “pavarësi financiare”? Pasi shërbimi është një institucion publik dhe, si i tillë, ai financohet nga buxheti i shtetit dhe respekton rregullat për menaxhimin e tij dhe, për më tepër, nuk ka burime të tjera të ardhurash përveç buxhetit të shtetit.

Së dyti, në nenin 8 të projektligjit flitet edhe për pagesat që përdoren në funksion të veprimtarisë hetimore dhe informative, si dhe për shpërblimin e personave që bashkëpunojnë me këtë shërbim. Ajo që doja të dija nga zëvendësministri është: çfarë përfaqësojnë këto raste dhe çfarë do të bëjnë konkretisht këta individë?

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zonja Dhima!

A ka pyetje të tjera? Edlira ka një pyetje.

Edlira Hyseni – Kisha vetëm një pyetje, kryetar.

Që ta kuptojmë qartë, ky është një ligj, të themi, pak më i vonuar (struktura është tashmë aktuale, 14 punonjës janë tashmë të punësuar dhe buxheti 18,8 milionë lekë ka nisur nga 2020-a në 2022-shin), pra po flasim për një ligj që e zyrtarizojmë sot, por, në fakt, në efekte financiare, strukturë, organigramë e të gjitha është tashmë realitet që në 2020-n? Sepse nuk e kuptova shumë 18,8 milionë lekë plus, që kërkohet për 14 punonjësit. Është tashmë fond i parashikuar në 2020-n dhe në 2021-shin, që e kemi kaluar në buxhet? Kështu që, le të themi që po bëjmë një ligj pasi e kemi ekzekutuar nga ana financiare. Jam e qartë dhe e saktë? Këtë doja të kuptoja, nëse ligji vjen pasi është bërë realitet, le të themi.

Anastas Angjeli – E kuptuam, jo që është bërë realitet, por e kuptuam pyetjen, besoj se edhe ekspertët e kuptuan.

Edlira Hyseni – Domethënë, është tashmë i parashikuar në buxhet.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – E kuptuam pyetjen, edhe ekspertët e kuptuan, edhe përfaqësuesja e Ministrisë së Financave, nëse është prezente, Vilma, e kuptoi.

Përgjigjen përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë për të tria pyetjet.

Edis Ibrahimi– Përshëndetje!

Së pari, në lidhje me pyetjet që bëri zonjë Dhima, dua të saktësoj që nuk flasim për një pavarësi financiare të shërbimit, por Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në burgje aktualisht funksionon si i ndarë, pra ka një varësi të dyfishtë, ku ka një varësi nga Ministria e Drejtësisë

për sa i përket drejtorisë qendrore dhe ka një varësi nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për sa u përket inspektorëve, që janë të atashuar pranë çdo IEVP-je. Për shkak se ne e pamë të arsyeshme që nuk mund të funksiononte në këtë mënyrë siç duhet dhe duke qenë se inspektorët, edhe pse nga ana funksionale dhe organizative japin llogari direkt te ministri i Drejtësisë, sepse është një strukturë që varet direkt nga ai, nga ana financiare ishin të varur nga burgjet. Kjo ka ndikuar edhe në punën e tyre, sepse në disa raste është vërejtur që ata kanë pasur një trysni nga drejtorët e burgjeve, pasi puna e inspektorëve në IEVP është lufta e korrupsionit dhe subjekte janë duke filluar që nga punonjësi më i thjeshtë deri te drejtori i çdo burgu. Për të eliminuar këtë lloj trysnie u pa e arsyeshme që të gjithë punonjësit të grumbulloheshin në strukturën e përgjithshme të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Burgje. Fondi buxhetor i përcaktuar në fondin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve tani kalon në fondin e drejtorisë së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Burgje. Kështu që nuk kemi një pavarësi financiare, por flasim për pavarësi financiare nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Për sa i përket...

Anastas Angjeli - Ju mund të keni edhe shumë të gjëra të tjera për të thënë, por këtu ne votojmë ato që ju shkruani dhe mënyra se çfarë keni shkruar në relacion, ku kërkohet pavarësi financiare, ose thuhet që arrihet një pavarësi financiare dhe, mënyra sesi jeni prononcuar ju për neni 8 nuk shkon me atë që ju keni në mendje dhe që thatë. Kështu që, kur të shkojmë te neni 8 do ta rregullojmë dhe, në të njëjtën kohë, në qoftë se rregullat juridike këtu e lejojnë, do ta rregullojmë edhe në relacion. Këtu ju thoni që kemi një shkopë nga Drejtoria e Kontrollit të Brendshëm nga pikëpamja financiare, ndërsa aty thoni që Kontrolli i Brendshëm do të ketë pavarësi financiare. Ju thoni që do të jetë brenda buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa te neni 8 thuhet që do të jetë zë më vete.

Mund të vazhdoni me pyetjen e dytë.

Edis Ibrahim - Për sa i përket pyetjes së dytë lidhur me shpërblimin e personave, përpilimin e fondit të posaçëm prej 100 mijë lekësh, i cili nuk ka qenë i përdorshëm...

Anastas Angjeli- Edhe atë do ta rregullojmë, nuk ka nevojë për komente. Ne do ta rregullojmë siç duhet, në mënyrë që edhe ata të shpërblehen, edhe puna të bëhet.

Vazhdoni me pyetjen e 3 të zonjës Edlira.

Edis Ibrahim - Për sa i përket pyetjes së zonjës Hyseni, në relacionin që është paraqitur, duke qenë se relacioni është paraqitur që në muajin gusht të vitit 2020, ka qenë e parashikuar një shtesë në punonjës prej 14 vetash, por, aktualisht, për shkak edhe të situatave që ndodhën vitin e fundit, por edhe pas tërmetit, na u desh që ta rivlerësonim edhe një herë strukturën e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Burgje dhe në draftin që është paraqitur në DAP për vlerësim, i cili

do të shkojë edhe për miratim, nuk kemi parashikuar më një shtesë prej 14 punonjësish të ri, por kemi vetëm një shtesë prej 5 punonjësish të ri, me një efekt financiar prej 2,8 milionë lekë në vit. Pra, fondi nuk është më 18,8 milionë, por është më i vogël, sepse, të detyruar nga situata që kaluam, na u desh ta rivlerësonim më mirë. Këto fonde janë të parashikuara në buxhetin e vitit 2021. Punonjësit nuk kanë filluar realisht punë. Shërbimi funksionon që prej vitit 2005 me një strukturë prej 59 punonjësish dhe shtesa prej punonjësish do të vijë vetëm pas miratimit të strukturës së re dhe fondet janë të parashikuar në buxhetin e vitit 2021.

Faleminderit!

Anastas Angjeli - Në përgjigjet që jepni duhet të jeni korrekt edhe me atë që keni shkruar këtu.

Edlira Hyseni - Mendoj se ky informacion i rëndësishëm duhet të jepet që në fillim, sepse në relacion e kemi të shkruar për 14 punonjës shtesë dhe 18,8 milionë lekë. Meqenëse e morëm këtë informacion, u gëzova shumë, sepse na u gjenden disa fonde të lira dhe ne i pëlqejmë këto lajme të mira. Ky është një lajm i mirë dhe më vjen mirë që kemi mundësi të përdorim fondet e mbetura nga 18,8 milionë.

Anastas Angjeli - Edlira, nuk ju mjaftoi që unë i bëra vërejtjen elegante, ku i thashë: “Qëndroi korrekt atyre që ke thënë relacion”, por kishit qejf ta thoshit dhe bëtë mirë që e thatë.

A ka diçka tjetër? Jo, nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale”.

Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet në parim ky projektligj me 2 vota abstenim dhe 1 votë kundër.

Po pyes zotin Rryçi dhe zonjën Topi a do të jenë me këtë qëndrim gjatë gjithë neneve, pra abstenim dhe një kundër?

Faleminderit që të mos e përsëris gjatë gjithë neneve, sepse kam 54 nene. Dua t’i qëndroj korrekt votimit tuaj. Abstenim, apo kundër, jeni zonja Topi?

Suzana Topi – Abstenim, zoti kryetar.

Anastas Angjeli – Zoti Rryçi?

Krenar Rryçi – Abstenim, zoti kryetar.

Anastas Agjeli – A kishte vota kundër? Vota kundër nuk kishte. Atëherë vazhdojmë votimin.

Neni 1. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8. Kush është dakord?

Duke parë formulimin që është bërë dhe duke marrë shkas nga pyetjet dhe përgjigjet që u dhanë, kemi bërë një riformulim të nenit 8 me dy pika, për të qenë korrekte me ligjin “Për menaxhimin e buxhetit” dhe me ligjin “Për miratimin e buxhetit për vitin 2021” .

Dua t’ju ftoj që t’i bashkoheni propozimit që këshilltarët bashkë me ekspertët e kanë bërë dhe besoj se do ta gjykojnë edhe gjatë zbardhjes përfundimtare me Komisionin e Ligjeve.

Neni 8 duhet përbëhet nga tri pika.

Pika 1: “Shërbimi ka buxhetin e tij brenda buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë.”

Pika 2: “Drejtori i shërbimit është përgjegjës për menaxhimin efektiv dhe me përgjegjshmëri të buxhetit të miratuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.”.

Pika 3. “Menaxhimi dhe zbatimi i buxhetit të shërbimit është objekt auditimi, sipas legjislacionit në fuqi.”. Kjo e sjell nenin përkatës në formën e duhur, në përputhje me ligjin e menaxhimit të buxhetit, si dhe në të njëjtën formë me ligjin e buxhetit të vitit 2021 që pyetën koleget Antoneta dhe Edlira.

Kush është dakord me nenin 8, me ndryshimet e propozuara? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 23. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 24. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 25. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 26. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 27. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.
Miratohet.

Neni 28. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.
Miratohet.

Neni 29. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.
Miratohet.

Neni 30. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.
Miratohet.

Neni 31. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.
Miratohet.

Neni 32. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.
Miratohet.

Neni 33. Kush është dakord? Abstenim? 2 abstenime. Kundër? Nuk ka.
Miratohet.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 34.

Kush është dakord?

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 35.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 36.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 37.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 38.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 39.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 40.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 41.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 42.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 43.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 44.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 45.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 46.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 47.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 48.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 49.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 50.

Sikurse ju thashë, edhe në nenin 8, në përgjigje të sqarimeve dhe të pyetjeve që u bënë, edhe në nenin 50, meqenëse lidhen me nenin 8, është bërë riformulimi që do t'ju propozohet si më poshtë për ta votuar atë në ndryshim me formulimin që ka paraqitur qeveria.

Neni 50. Paga e punonjësve dhe pagesave të tjera. Riformulohet në këtë mënyrë:

1. Paga e punonjësve të shërbimit përbëhet nga paga bazë, shtesat për vjetërsi në punë, shtesa e pozicionit dhe shtesa për kushtet e punës.

2. Pagesa e individëve jashtë shërbimit, që funksionojnë në funksion të veprimtarisë hetimore e informative përballohen nga fondi i veçantë i buxhetit të shërbimit.

3. Kushtet dhe kriteret për përdorimin dhe kontrollin e fondit të veçantë caktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e drejtësisë. Për arsye se te paga ishin futur dietat, ishin futur shërbimet, ishte bërë një ngatërrësë që nuk bëhet ndonjëherë.

A jeni dakord me këto ndryshime?

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 51.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 52.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 53.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 54.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 55.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 56.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 57.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 58.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 59.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 60.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 61.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 62.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 63.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 64.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Votojmë projektligjin në tërësi.

Faleminderit!

Abstenim? 2 vota. Kundër? Nuk ka.

Miratohet me shumicë votash projektligji “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm dhe ankesat në sistemin e ekzekutimit e vendimeve penale”.

Faleminderit, të ftuarve!

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.2.2021, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i planit vjetor 2021 për zbatimin e programit të statistikave zyrtare 2017 – 2021.

Marrin pjesë:

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Xhevit Bushaj, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Ervin Bushati, Antoneta Dhima, Korab Lita, Blerina Gjylameti, Roland Xhelilaj, Reme Lala, Suzana Topi, Ylli Shehu dhe Arben Elezi.

Mungojnë:

Vullnet Sinaj, Eljo Hysko.

Të ftuar:

Elsa Dhuli - Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT-it

Kesjana Halili - Sekretare e Përgjithshme e INSTAT-it

Maldi Dema - Drejtor për Koordinimin dhe Çështjet Ligjore në INSTAT

Helda Mitre - Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të IT-së në INSTAT

Anastas Angjeli - Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës.

Bëjmë përsëri apelin për kuorumin dhe pjesëmarrjen dhe do të vazhdojmë me çështjen që ka të bëjë me miratimin e planit vjetor 2021 për zbatimin e programit të statistikave zyrtare 2017-2021.

Prezentë: Anastas Angjeli, Senida Mesi, Xhevit Bushaj, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Ervin Bushati, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Korab Lita, Blerina Gjylameti, Roland Xhelilaj, Reme Lala, Suzana Topi, Ylli Shehu, Arben Elezi

Mungojnë: Elio Hysko, Vullnet Sinaj ishte, por është çaksuesar. Korabi është këtu; Ylli Shehu dhe Suzana Topi janë këtu.

A e kemi kuorumin? Meqenëse është kuorumi, vazhdojmë.

Për sa i përket diskutimit dhe miratimit të planit vjetor 2021 “Për zbatimin e programit të statistikave zyrtare 2017-2021”, këtu janë përfaqësuesit e Drejtorisë së INSTAT-it.

Përshëndetje, zonja Elsa, drejtore e Përgjithshme, së bashku me stafin!

Faleminderit!

Nga Ministria e Financave janë Endriti dhe Moza. Relator jam caktuar unë.

Fjala është për ju, zonja Elsa, për të bërë një prezantim të shkurtër, pasi të gjitha materialet u janë vënë në dispozicion anëtarëve të komisionit me anë të postës elektronike.

Elsa Dhuli – Ju faleminderit!

I nderuar zoti kryetar i Komisionit,

Të nderuar deputetë,

Siç u theksua, projektplanin vjetor 2021 është dokumenti i tretë i këtij lloji, i cili i paraqitet për miratim Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të neneve 9 dhe 10 të ligjit “Për statistikave zyrtare”. Dokumenti shërben për parashikimin e veprimtarive statistikore në përmbushje të objektivave strategjike dhe rezultateve të pritshme të parashikuara në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021, miratuar me vendimin e Kuvendit të vitit 2017.

Mbështetur në pikën 2 të nenit 9 të ligjit “ Për statistikave zyrtare”, INSTAT-i është përgjegjës për përgatitjen e planit vjetor në bashkëpunim me agjencitë e tjera statistikore, pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor për të planifikuar operacionet, burimet dhe rezultatet e pritshme të vitit 2021, si dhe për të përcaktuar përgjegjësitë e aktorëve institucionalë të përfshirë për sigurimin, mbledhjen, përpunimin, prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare. Sikurse jeni të informuar, Sistemi Kombëtar Statistikor përbëhet nga 3 prodhues të statistikave zyrtare, si: INSTAT-i, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të cilët mbledhin, përpunojnë dhe publikojnë statistika zyrtare sipas programit.

Në tërësinë e tij, projektplanin paraqet 136 aktivitete statistikore që do të kryejnë këto institucione gjatë vitit 2021, sipas 4 fushave përkatëse statistikore: statistika sociale dhe demografike; statistika ekonomike; statistika sektoriale; statistika të mjedisit dhe shumëfushave, të shoqëruar me afatet përkatëse.

Më tej në të paraqiten institucionet që janë përgjegjëse për dhënien e informacionit statistikor dhe frekuencën e transmetimit të këtij informacioni: mujor, tremujor dhe vjetor. Me qëllim që të sigurohet mbarëvajtja e veprimtarive të parashikuara dhe parandalimi i pengesave të mundshme, dokumenti përmban edhe një analizë të risqeve dhe problemeve të pritshme, të cilat lidhen me: vazhdimësinë, cilësinë statistikore, komunikimin ndërmjet njësive organizative dhe institucionit, komunikimin ndërinstytucional, mbledhjen e të dhënave me vonesë dhe jo në cilësinë e duhur, shkallën e ulët të përgjigjes nga njësitë statistikore apo zhvillimi i kapaciteteve të stafit.

Përmbajtja e projektplanit vjetor 2021 është në linjë të plotë me kërkesat dhe standardet e kërkuara nga Bashkimi Europian dhe Eurostat, në bazë të së cilës e ushtrojnë veprimtarinë e tyre sistemet kombëtare statistikore të vendeve anëtare të BE-së.

Aktivitetet që janë parashikuar në projektplanin vjetor, janë në funksion të përmbushjes së rekomandimeve për integrimin e Shqipërisë në BE, në fushën e statistikave, veçanërisht atyre që kanë të bëjnë me përmirësimin e statistikave makroekonomike, statistikave të bujqësisë, statistikave strukturore të ndërmarrjeve apo atyre të mjedisit dhe energjisë.

Në mënyrë që të pasqyrohet i gjithë informacioni i duhur, projektplanin vjetor 2021 përbëhet nga dy pjesë:

Në pjesën e parë, i strukturuar sipas shtojcës nr. 1 të ligjit “Për statistikat zyrtare” paraqitet një informacion i përgjithshëm për përmbajtjen e projektplanit vjetor dhe pasqyrohen objektivat strategjike të përcaktuar në programin e statistikave zyrtare 2017-2021 dhe aktivitetet për zbatimin e tyre.

Gjithashtu, në të përshkruhen shkurtimisht aktivitetet statistikore që do të kryhen për secilën fushë. Rrjedhimisht 41 aktivitete për statistikën sociale dhe demografike, 22 aktivitete për statistikën makroekonomike, 62 aktivitete për statistikën sektoriale, 11 aktivitete për statistikën e mjedisit dhe shumëfusha, ku INSTAT-i planifikon të kryejë 103 aktivitete; Banka e Shqipërisë 10 aktivitete dhe Ministria e Financave 2 aktivitete. Për çdo aktivitet përcaktohen institucionet përgjegjëse për prodhimin e statistikave, si dhe institucionet që janë të detyruara të japin të dhënat administrative. Më tej listohen treguesit kryesorë statistikorë që do të prodhohen gjatë vitit.

Pjesa e dytë përbëhet nga aneksi 1 i projektplanit vjetor 2021, i cili është hartuar sipas klasifikimit të përcaktuar në shtojcën 1 të ligjit “Për statistikave zyrtare”.

Një pjesë e veçantë të programit janë aktivitetet lidhur me censet. Gjatë vitit 2021 INSTAT-i do të vazhdojë punën përgatitore për realizimin e censit të popullsisë dhe banesave. Hyrja në fuqi e ligjit do të mundësojë formalizimin e datës së censit, nëpërmjet planit vjetor për

zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare, si dhe do të mandatojë ngritjen e strukturave ndërinstitucionale mbështetëse për kryerjen e këtij procesi. Do të zhvillohen teste të tjera, si dhe një pilot i dytë, ku një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përditësimit, implementimit dhe monitorimit të strategjisë së komunikimit, do të vazhdojnë aktivitetet për përditësimin e zonave specifike në terren të censit, sidomos në zonat e prekura nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të 26 nëntorit apo e objekteve të tjera në ndërtim, të identifikuara gjatë përditësimit të hartave të kryera gjatë periudhës 2019-2020.

Do të vazhdojë puna në lidhje me zhvillimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në mbështetje të censit, për përmirësimin e pyetësorit të censit, si dhe të materialeve të tjera shoqëruese.

Gjithashtu, gjatë vitit 2021 do të fillojë puna përgatitore për realizimin e censit të bujqësisë dhe të fermave bujqësore, një tjetër aktivitet madhor ky në fushën e statistikave.

Fillimisht, INSTAT do të hartojë strategjinë dhe planin e veprimit të censit. Strategjia do të përshkruajë kërkesat ligjore, teknologjike, operationale dhe buxhetore në lidhje me këtë aktivitet. Në aspektin e përcaktimit të kuadrit ligjor për kryerjen e censit të bujqësisë, brenda vitit 2021 INSTAT do të hartojë projektligjin e ri për censin e bujqësisë dhe të fermave bujqësore, i cili më pas do të dërgohet për miratim në Kuvendin e Shqipërisë.

Së fund, dëshiroj të theksoj se situata e krijuar nga pandemia Covid 19 vazhdon të ketë një ndikim të rëndësishëm në të gjitha aspektet e jetës. Gjithashtu, ky impakt ka qenë edhe në fushën e statistikave.

Në mënyrë të pashmangshme, shëndeti publik ka qenë prioritet i INSTAT-it, duke vazhduar të mbetet i tillë edhe në vijim. Në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia, INSTAT ka marrë një sërë masash për të ulur ndikimin e saj në të gjitha proceset dhe procedurat statistikore, për të siguruar vazhdimësinë dhe cilësinë e prodhimit statistikor, në mbështetje të misionit kryesor të këtij institucioni.

Duke ju falënderuar paraprakisht për mbështetjen tuaj, zoti kryetar dhe të nderuar deputetë, mbetemi me shpresë në lidhje me miratimin e këtij dokumenti.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zonja Elsa Dhuli!

Ky projektplan vjen në komision për t'u diskutuar dhe për t'u miratuar nga Kuvendi, në zbatim të neneve 9 e 10 të ligjit 17/2018 "Për statistikave zyrtare". Kësisoj, ne kemi obligimin ta diskutojmë sot, por natyrisht edhe ta votojmë e t'ia përcjellim Kuvendit brenda afateve që përcakton ligji.

Ky projektplan paraqet aktivite statistike qe do te kryhen nga INSTAT, nga Banka e Shqiperise dhe Ministria e Financave dhe Ekonomise gjate vitit aktual 2021, ne permbushje te detyrimeve qe lindin nga programi i statistike zyrtare 2017-2021, miratuar me vendimin e Kuvendit, nr. 9. 2. 2017, sipas kushteve perkatese statistike qe mbulojne, shoqeruar edhe me detyrat dhe afatet perkatese.

Me qellim qe te sigurohet mbarevajtja e veprimtarive te parashikuara dhe parandalimi i pengesave qe mund te dalin, dokumenti permban edhe nje analize te te gjitha risqeve dhe problemeve potenciale qe mund te ndeshen.

Ky projektplan eshte përafuar plotësisht me nenin 17 te planit vjetor te Rregulloses se KE-se, nr 223/2009 te Parlamentit Europian e te Keshillit Europian, date 11 mars 2009 "Mbi statistikat europiane", e cila shfuqizoi rregulloren e meparshme nr. 1101/2008 te Parlamentit Europian dhe Keshillit Europian, mbi dergimin e te dheneve, te cilat u nenshtrohen konfidencialitetin statistikor, Zyres Statistike te Komuniteteve Europiane, Rregulloses se Keshillit Europian mbi statistikat e komunitetit dhe vendimin e Keshillit Euratom per krijimin e nje komisioni mbi programet statistike te komuniteteve europiane.

Ky projektplan i ardhur paraqet disa perparesi. Kryesisht, do te siguroje permbushjen e rekomandimeve te Bashkimit Europian, per sa i perket miratimit te nje plani konkret pune ne harkun e nje viti, ne nivel kombetar; do te mundesoje percaktimin konkret te aktiviteve qe mbulohen nga prodhuesit e statistike zyrtare, te cilat jane pjesë e sistemit tone kombetar statistikor; do te mundesoje konkretizimin e institucioneve pergjegjese per dhënien e se drejtes per hyrje ne te dhënat administrative qe disponojme, vetem per qellim statistikor; do te percaktojë afatet e kryerjes se aktiviteve per secilen fushë statistike, ne menyre qe te lehtesohet procesi i monitorimit dhe i raportimit te ecurise se veprimeve statistike ne vend. Do te rrisë transparencën e institucioneve te angazhuara ne proceset e prodhimit statistikor zyrtar, duke rritur imazhin dhe besueshmerine e perdoruesve te statistike, si dhe do te percaktojë aktivitetet qe parashikon te kryejë INSTAT-i per parandalimin ose reduktimin e pasojave qe mund te shkaktohen nga situata e pandemisë globale Covid 19.

Objektivat strategjike te zhvillimit te sistemit kombetar statistikor, te parashikuara ne kete program, ne programin 2017-2021, jane harmonizimi i kuadrit ligjor me Bashkimin Europian, permiresimi i cilesise statistike, zhvillimi i infrastrukturës dhe i kapaciteteve profesionale te strukturave te prodhimit statistikor, rritja e rolit te perdoruesve ne procesin e aktivitetit statistikor, permiresimi i bashkepunitimit institucional, zhvillimi i proceseve te shperndarjes se statistike dhe zhvillimi i burimeve njerëzore, per te rritur te gjitha kapacitetet e nevojshme profesionale te statisticienëve.

Plani vjetor i vitit 2021 përmban listën e aktiviteteve statistikore e të afateve kohore, listën e burimeve statistikore dhe institucionet përgjegjës, listën e institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare, analizën e risqeve dhe problemeve potenciale për kryerjen e aktiviteteve, regjistrat statistikorë që do të krijohen, do të zhvillohen e do të mirëmbahen, si dhe rishikime të mundshme të programit të statistikave zyrtare, fushat kryesore në të cilat do të shtrihet kjo veprimtari nga statistikat demografike dhe sociale, statistikat ekonomike, statistikat elektorale, statistikat e mjedisit dhe të multidomenit. Gjithashtu, një vëmendje e veçantë i përcaktohet censusit të popullsisë dhe të banesave.

Siç jeni në dijeni, puna përgatitore për censusin e ardhshëm të popullsisë dhe të banesave është aktiviteti më i rëndësishëm i vitit, pasi do të mundësojë shtimin dhe përmirësimin e të dhënave statistikore në disa fusha, të cilat do të shërbejnë më pas për krijimin e politikave të mbështetura në statistika dhe në përcaktimin e qëllimeve dhe të planeve socio-ekonomike për zhvillimin e qëndrueshëm në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, si dhe për një sistem statistikor të qëndrueshëm dhe efikas.

Pandemia globale COVID-19 ka ndikuar në aktivitetin e Instat-it, përfshirë punën përgatitore për censusin. Instat-i e ka përshtatur aktivitetit e censusit, duke mbajtur në konsideratë edhe mbrojtjen e shëndetit, si dhe sigurimin e një cilësie të lartë të këtij aktiviteti të rëndësishëm statistikor.

Censi i bujqësisë është i radhës, duke ndjekur rekomandimet e Programit Botëror të Censit në bujqësi për vitin 2020, dhe është planifikuar të kryhet pas analizimit dhe përditësimit të bazës së zgjedhjes së të dhënave të gjeneruara nga censi i popullsisë dhe i banesave.

Projektplani i statistikave zyrtare është detyrim, siç e theksova që në fillim, prandaj ne duhet ta diskutojmë dhe nëse ka ndonjë mendim apo pyetje, si dhe pa dyshim ta përcjellim atë në parlament për ta votuar me qëllimin që veprimtaria e këtij institucioni të vazhdojë përputhur me këtë plan që ka paraqitur.

Faleminderit!

Kush ka pyetje?

Edlira, ka një pyetje.

Kush ka tjetër pyetje?

Po, edhe zoti Ryçi ka pyetje.

Zoti Ryçi.

Krenar Ryçi – Faleminderit, kryetar!

Falënderoj deputeten që më dha të drejtën e fjalës, më shumë më la radhën...

Anastas Angjeli – Të drejtën ta jap unë.

Krenar Ryçi – Derisa po flisnim për radhën ju keni të drejtë se jeni kryetari.

Anastas Angjeli – E kisha me shaka.

Krenar Ryçi – Kryetar, ju ndoqa me vëmendje ju dhe shefen e Instat-it. Kam dy pyetje.

E para, nëse Instat-i ka ndonjë listë në lidhje me popullatën?

E dyta, sa është numri i popullatës së Shqipërisë për vitin 2020 dhe sa shqiptarë janë larguar nga Shqipëria gjatë këtij viti?

Kjo është pyetja që më intereson më shumë.

Sa i takon planit të punës dhe aktivitetit që bën Instat-i e kanë detyrë ligjore.

Shqetësimi im lidhet me këto dy gjëra: numri i popullsisë, pasi jemi para zgjedhjeve dhe sesa shqiptarë janë larguar nga Shqipëria për arsye të ndryshme.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, Krenar!

Edlira.

Edlira Hyseni - Faleminderit, kryetar!

Kam një pyetje të thjeshtë.

E para, me aq sa kuptova dhe me sa u tha censusi i popullsisë dhe i banesave nuk parashikohet për vitin 2021.

E dyta, më duket shumë interesant censusi i bujqësisë dhe për fermat bujqësore.

Dua të di nëse është bërë më parë? Cili ka qenë censusi i fundit që është bërë në Shqipëri? A mund të na thuhet se çfarë objektivash synohen konkretisht?

Mua më duket që Shqipëria ka nevojë për një studim të tillë dhe besoj të jemi më në fund në kohën e duhur për t'i dhënë bujqësisë vëmendjen dhe kohën që meriton, duke qenë një ndër sektorët që i duhet ekonomisë për rimëkëmbjen.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, Edlira!

Zonja Dhuli, ju lutem përgjigjen shkurt dhe saktë për të tria pyetjet!

Elsa Dhuli – Në lidhje me pyetjen e parë që ka bërë zoti Krenar, dua ta falënderoj për pyetjen!

Mund t'ju them se shifra zyrtare e publikuar për popullsinë është ajo e vitit 2019, ndërsa për vitin 2020 jemi në proces përlllogaritjeje, është 2 845 000. Në statistikat tona nuk kemi një shifër të saktë të hyrjeve dhe daljeve, pasi duhet të bëhet një analizë shumë më e detajuar, megjithatë në një publikim të fundit paraqitet lëvizja e shtetasve shqiptarë nga periudha e censit të kaluar deri në këtë periudhë.

Në lidhje me pyetjen e dytë mbi censin e bujqësisë, mund t'ju bëj me dije se në vitin 2012 është organizuar censi i bujqësisë, i dyti pas atij të organizuar në vitin 1998. Censi i ardhshëm i bujqësisë do të zhvillohet menjëherë pas censit të popullsisë, pasi nëpërmjet pyetësorit të censit të popullsisë është përfshirë një modul i veçantë mbi të cilin do të mblidhet informacion mbi numrin e fermave bujqësore dhe blegtorale dhe do të ndërtohet baza për daljen në terren të censit të bujqësisë.

Pyetësi do të përfshijë një informacion shumë më të zgjeruar jo vetëm mbi numrin dhe madhësinë e fermave bujqësore dhe blegtorale, por edhe për produktet bujqësore apo numrin e krerëve në blegtori, informacion mbi sistemin e mekanizimit të bujqësisë, informacion mbi punësimin, por gjithashtu do të përfshihen edhe statistika gjinore në lidhje me përfshirjen e gruas në procesin e bujqësisë.

Pra, do të jetë një pyetësor, i cili do të përmbajë pyetje të shumëllojshme dhe të shumëfishta, të cilat do të mbulojnë aspekte shumë të gjëra në lidhje me bujqësinë dhe blegtorinë.

Në lidhje me shtyrjen e censit të popullsisë është propozuar tetori i vitit 2022. Pra, meqenëse është kjo distancë kohore është e domosdoshme që në tetor të vitit 2021 të kryhet një pilot i dytë, i cili do të realizohet në 10 bashki të zgjedhura të vendit, pas 3 testeve. Në ato raste që do të kryhen nga tani deri në tetor të vitit 2021.

Ansatas Angjeli – Faleminderit, zonja Dhuli!

Që të vazhdojmë procedurën për t'ia përcjellë Kuvendit për miratim planin vjetor të vitit 2021 “Për zbatimin e programit të statistikave zyrtare”, ne duhet të votojmë projektvendimin për këtë qëllim, i cila ka këtë përmbajtje: “Për shqyrtimin e planit vjetor 2021 “Për zbatimin e programit të statistikave zyrtare 2017 – 2021”. Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe pikës 5 të nenit 9 të ligjit nr. 17/2018, “Për statistika zyrtare”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi:

1. Të miratohet plani 2021 për zbatimin e programit të statistikave zyrtare 2017-2021.
2. Plani vjetor 2021 të botohet në Fletoren Zyrtare.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

Kush është dakord me projektvendimin? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, zonja Dhuli, që ishit me ne për të mbrojtur këtë projektvendim, që do t'i përcillet seancës plenare.

Elsa Dhuli- Faleminderit!

**Sekretar
Anastas Angjeli**

**Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili**

**Sekretar i komisionit
Elvi Prifti**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.2.2021, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Vendimi i Kuvendit për përcaktimin e fondit për subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet 2021.

Marrin pjesë:

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Xhevit Bushaj, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Ervin Bushati, Antoneta Dhima, Korab Lita, Blerina Gjylameti, Roland Xhelilaj, Reme Lala, Suzana Topi, Ylli Shehu dhe Arben Elezi.

Mungojnë:

Vullnet Sinaj, Eljo Hysko.

Të ftuar

Mimoza Dhemi – Drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Ylli Merkaj – Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së

Mirela Gega – Drejtoreshë e Financës në KQZ

Anastas Angjeli - Kalojmë në çështjen tjetër. Besoj se aksesimi i pjesëmarrësve është i gjithi. Siç jeni në dijeni, më 25 prill zhvillohen zgjedhjet elektorale në vendin tonë. Qeveria, Kuvendi dhe KQZ-ja po përgatiten me seriozitetin më të madh për të përgatitur zgjedhje sa më korrekte, transparente dhe me standardet më të larta që nevojiten. Për këtë qëllim është e domosdoshme që në dispozicion të KQZ-së të vihen edhe fondet financiare. KQZ-ja i është drejtuar Kuvendit, sepse kjo është procedura, dhe ka vënë në dijeni edhe Ministrinë e Financave, që në përputhje me ligjin nr. 1019, datë 29.09.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.101/2020, neni 88, pika 1, parashikon se partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe që kanë marrë jo më pak se 1% të votave në shkallë vendi në zgjedhjet më të afërta pararendëse të të njëjtit lloj, përfitojnë fonde nga buxheti i shtetit në bazë të numrit të votave që secila parti ka marrë në ato zgjedhje. Fondi për këtë qëllim është përcaktuar me vendim të Kuvendit dhe përbën zë më vetë në buxhetin e shtetit për vitin zgjedhor përkatës. Referuar nenit 180, pika 4, të Kodit zgjedhor përcaktohet se në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, fondi nga buxheti i shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje do të jetë 2 herë më i madh se fondi i alokuar për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017. Fondi i shpërndarë për partitë politike në vitin 2017 ka qenë 65 milionë lekë, si rrjedhojë fondi për këtë qëllim për vitin 2021 duhet të jetë 130 milionë lekë. Kërkojnë nga ana jonë që ne të bëjmë vendimin përkatës për këtë. Drejtorja e Buxhetit është prezent, sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është prezent. Kur kemi miratuar buxhetin e vitit 2020 këto fonde janë përfshirë në buxhetin e shtetit, por dua t’ju bëj me dije ju dhe opinionit publik se nuk janë vetëm këto që do të miratojmë sot, sepse dje ka kaluar edhe një vendim i qeverisë dhe një akt normativ, që bën ndryshimin në buxhetin e vitit 2020, ku KQZ-së për të plotësuar të gjitha nevojat do t’i vihen në dispozicion edhe 1 miliard lekë të rinj që ne do t’i diskutojmë kur të vijë akti normativ në Komisionin e Ekonomisë dhe në parlament.

Qeveria, Kuvendi i Shqipërisë garantojnë plotësisht të gjitha nevojat financiare që KQZ-ja ka për të realizuar në zgjedhjet e 25 prillit, në mënyrën më korrekte transparente, siç e thashë në fillim, me të gjithë infrastrukturën dhe nevojat që kanë partitë politike, me qëllim që zgjedhjet të zhvillohen të lira dhe demokratike.

Fjalën e ka sekretari i Përgjithshëm dhe pastaj Moza.

Përfaqësuesit e KQZ-së a kanë ndonjë gjë për të shtuar?

Siç e relatuat edhe ju, fondi për këtë qëllim përcaktohet më vendim të Kuvendit dhe përbën zë më vete në buxhetin e shtetit për vitin zgjedhor përkatës. Neni 180 i Kodit Zgjedhor, pika 4, përcakton se në zgjedhjet e para, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, fondi nga buxheti i shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje do të jetë 2 herë më i madh se fondi i alokuar për zgjedhjet parlamentare të përgjithshme të vitit 2017.

Me vendimin e Kuvendit nr. 59/2019, sasia e fondit nga buxheti i shtetit që do t'u ndahet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të vitit 2019 është 65 milionë lekë. Kështu që fondi që kërkon KQZ-ja për zgjedhjet është 130 mijë euro.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Fjala për ju, zonja Mimoza.

Mimoza Dhëmbi – Ne e kemi pasur të qartë që në fillim që fondi për fushatat e partive do të ishte 130 milionë, pasi Kodi Zgjedhor e ka përcaktuar saktësisht që është dyfishi i fondit të dhënë në vitin 2017 dhe në buxhetin e vitit 2021 kishim vendosur 1 miliard lekë për të gjithë koston e zgjedhjeve. Mirëpo, për shkak të ndryshimeve të rëndësishme në Kodin Zgjedhor, kostoja e zgjedhjeve mund të shkojë edhe më shumë se sa 1 miliard, që ishte vendosur. Kështu që ne jemi të përgatitur që fondi për partitë, plus edhe fonde të tjera që mund të kërkohen për arritjen e standardeve të Kodit Zgjedhor, do të përballohen nga fondi rezervë. Në aktin normativ që do t'ju sjellim së shpejti, ne do të prezantojmë të gjitha ndryshimet që lidhen me koston e zgjedhjeve. Për KQZ-në është vendosur një fond prej 2,4 miliardë, jo 1 miliard që ishte vendosur në fillim, i cili nënkupton financimin e projektit që ka të bëjë me kontrollin biometrik. Duke qenë një kosto kaq e madhe dhe e paparashikuar në buxhetin e vitit 2021, ne u detyruam të ndryshonim aktin normativ, për arsye se kostoja na erdhi pasi buxheti ishte miratuar në parlament.

Gjithashtu, ne kemi shtuar edhe fondin rezervë në aktin normativ për 1 miliard lekë, kështu që i kemi të gjitha mundësitë që të financojmë edhe disa elemente të tjera, që lidhen me pilotimin në disa zona të numërimit elektronik, që lidhet me sistemin e kamerave e të tjera. Pra, nëpërmjet këtij akti ne sigurojmë plotësisht edhe fondin për fushatat e partive, plus edhe elementet e tjera të Kodit Zgjedhor të jenë plotësisht të financuara.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Keni ndonjë pyetje tjetër?

Edlira Hyseni – Doja të pyesja, kështu si duket, deri në zgjedhjet e ardhshme, që do të bëhen pas dy muajve, parashikimet financiare ende janë të paqarta, se sa do të shkojë kostoja e zgjedhjeve. Rishikimin e buxhetit me aktin normativ, besoj se do ta bëjmë së shpejti, por ne as një muaj nuk kemi që e diskutuam buxhetin dhe...

Anastas Angjeli – Edlira, të lutem, kam një ndërhyrje!

Pyetjen e dua vetëm për vendimin që do të marrim sot, për aktin normativ, ndërsa rishikimin do ta diskutojmë radhës tjetër.

Kemi pasur një ditë të gjatë, kemi kaluar shumë çështje, ju lutem, bëni direkt pyetjen për vendimin e sotëm. Jemi në përputhje me ligjin dhe ne si Kuvend na takon vetëm kaq, të bëjnë një vendim që kjo të ekzekutohet. Kështu e ka ligji. Kurse për aktin normativ, për mënyrën si do të veprohet dhe si do të përballohet do ta bëjmë publike.

Edlira Hyseni – Pra, për ta kuptuar përmbledhtazi, fondi 130 milionë lekë që miratojmë sot është i parashikuar tashmë, nuk ka lidhje me 1 miliard dhe ndryshimet e tjera. Ishte i parashikuar dhe a mund të dimë nëse qëndron si informacion se si do të shpërndalet kjo shumë apo nuk dihet ende?

Faleminderit!

Anastas Angjeli – E para, këtë 130 milionësh e ke votuar me dorën tënde bashkë me mua në buxhetin e vitit 2020, që e kemi diskutuar në dhjetor. Është dekretuar nga Presidenti i Republikës, ka filluar zbatimi i tij dhe të gjithë anëtarët e komisionit kanë qenë pjesëtarë në të.

Ne bëjmë një akt do të thosha deri diku formal nga pikëpamja e procedurës për t'ia vënë në dispozicion KQZ-së, e cila duhet t'ua vejë në dispozicion partive politike. Kjo është çështja.

Natyrisht, është një fond i dyfishuar, sepse kështu e ka ligji, dhe është më mirë, aq sa ka mundësi buxheti i shtetit, t'i financojë partitë politike që të mos lejojmë më rrugë të tjera të financimit të partive politike. Ky është qëllimi i qeverisë, i Kuvendit të Shqipërisë, edhe i votuesve shqiptarë. Ne këtë po bëjmë.

Sa i përket pyetjes se sa do t'u jepet partive politike, ka një formulë në legjislacion, e cila të çon direkt në shumën absolutet. Shumëzo tabelën me të dhënat që ka legjislacioni për partitë politike me shumën 130 milionë dhe del shuma që i takon çdo partie politike. Ndërkaq, KQZ-ja e ka bërë këtë të ditur.

Po lexoj projektvendimin “Për miratimin e fondit për financimin e parive pjesëmarrëse për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2021”.

“Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 88, pika 1, dhe 180, pika 4, të ligjit nr. 1019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimet e Kuvendit nr. 51/2017, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi:

1- Fondi i alokuar i buxhetit të shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2021, do të jetë në vlerën 130 milionë lekë.

2- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Një votë abstenim.

Miratohet.

Falënderoj përfaqësuesit e Ministrisë së Financave që ishin 2-3 orë bashkë me ne për diskutimin e projekteve që diskutuam sot!

Falënderoj përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoreshën e Statistikave!

Falënderoj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve!

Ju uroj të gjithëve punë të mbarë!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

**Sekretar
Anastas Angjeli**

**Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili**

**Sekretar i komisionit
Elvi Prifti**